



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01Nr. 60/01-1913/24
Kaçanik, 24.01.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I (parë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24 janar 2024 Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës: Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Hafize Sallahi-DKRS, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët, Visar Mulaku, Mavije Murseli.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Mafire Malsiu- ZLP për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pjesëmarrës në këtë mbledhje janë 7 anëtarët- të gjithë. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e I (parë) të rregullt të KPF-a për vitin 2024, data 24 janar me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;
3. Raporti Financiar i TM4 për vitin 2023;
4. Plani Vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024;
5. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;
6. Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2023;
7. Propozim Vendimi për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut;
8. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri;

9. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi;
10. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli;
11. Propozim Vendim për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut;
12. Njoftim me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T – DIAP për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 12 pikave.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 20.12.2023 / Lënda: 01Nr. 060/01-30020/23.

2. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, është bukur voluminoz, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Agim Mani: E cekët edhe ju kryesues se materiali është voluminoz, kjo është e vërtetë, ndërkaq nëse shikohet në zbatim ky plan, ka probleme sepse duhet të jetë i harmonizuar me buxhetin e komunës dhe ndarjet buxhetore në secilën drejtori. Qëllimi se çka synohet është diçka tjetër, ndërsa realizimi diçka tjetër, sepse plani bëhet për atë çka mundesh me realizuar. Me qenë plan strategjik, synimet janë me të mëdha, ndërkaq si plan i ekzekutivit mendoj që objektivat duhet të jenë të harmonizuara me buxhetin, me pasur mundësi me i realizuar ato që janë planifikuar. Pata disa pyetje për drejtorin e Bujqësisë dhe për drejtorin e Urbanizmit, por nuk qenkan këtu, këto pyetje do i ngriti në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i DUKMM e ka këtu në mbledhje një përfaqësues.

z. Visar Mulaku: Unë jam i autorizuar për Propozim Vendimet për çështje e këmbimit të pronës, ndërkaq për Planin e punës së Ekzekutivit, nuk jam i autorizuar.

znj. Ardita Rrahmani: Ne jemi të thirrur me iu mbajt për fjale për objektivat e paraqitura në plan. Të pjesa hyrëse, në vitet tjera duhet me i ndryshuar, se nuk është aktivitet bashkëpunimi ndër komunal, thellimi i transparencës, bashkëpunimi me asociacionin e komunave, bashkëpunimi i ngushtë me nivelet qendrore, sepse këto janë detyrime. Për mua aktivitet është koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm, kurse këto objektivat tjera të paraqitura janë detyrime. Plani është i ekzekutivit, ne nuk mundem me ndërhyrë, se tek e fundit këto janë

premtimet e juaja gjatë fushatës, kështu që ju i keni planet në harmoni me programet e juaja se ku keni menduar me investuar. Uroj të realizohen objektivat që janë në interes të qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Planin për arritjen e objektivave, ekzekutivi e bënë me i caktuar orientimet se çka ka me arritur gjatë një viti, ndërkaq në KK plani vjen me u diskutua, për me ditur KK se çfarë objektivash dhe synimesh i ka vendosur vetës, ndërkaq KK e monitoron ekzekutivin se a po i realizon ato objektiva që ia ka vendosur vetes. Të çështja e aktiviteteve, ka mundësi të quhen aktivitete e detyrime, por asnjë aktivitet nuk mund të bëhet pa ia vendosur vetës detyrim, se secili detyrim ka aktivitete në bazë të ligjit, për me realizuar një qëllim apo synim. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që t'i shkoj KK ky plan pune, njëzëri u pajtuan. Në saje të kësaj del konstatimi, **se KPF e shqyrtoj Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024. Ky Plani i punës i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit.**

3. Raporti Financiar i TM4 për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Këtë herë Raporti financiar ka ardhur me ndryshe, e ka dërguar ZKF. Unë e kam kontaktuar drejtorin e DBF, se raportin duhet me dërguar drejtori ose kryetari. Drejtori ka qenë në pushim, ZKF i ka përcjellë tabelat ashtu siç janë, të cilat tabela janë për konsumim të brendshëm. Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Zakonisht Raportin katër mujor financiar e kemi bërë në përmbledhje të raportit vjetor financiar. Është hera e parë që bëhet një raport i tillë për shkak se organizatat e huaja, si DEMOS etj. po kërkojnë për me pasur një pasqyrë të realizimit të buxhetit dhe për arsye të Grantit të Përfomancës për mos me humbur pikë Unë kam qenë në pushim, por kjo nuk e arsyeton faktin mos me u bërë raporti. Raporti është i papërpunuar, për KK kemi me përmbledhur, se në këtë format nuk është i përgatitur për publikun. Kërkoj falje që ka ardhur raporti në këtë formë, se është i pakapshëm për KK. Unë e përmirësoj me vërejtjet që dalin këtu dhe raporti në KK iu vjen i përmbledhur.

z. Agim Mani: Raporti duhet të ketë një përmbajtje me ndryshe, edhe pse ky raport është me i detajuar. Unë kam paqartësi të shpenzimet të Pagat dhe Mëditjet. Qysh mundet me kredituar mjete nga Pagat dhe Mëditjet në vitin 2024, se ajo nuk është e hyrë, nga ka rrjedhë atëherë kreditimi, ndërkaq debitimi dihet? Kemi kreditim dhe debitim edhe në pozicione tjera, të Subvencionet dhe Transferet, ka pasur mundësi të participimi me 1226 euro kreditim. Të Investimet kapitale, kreditimi është zero. Në këtë raport nuk janë bërë krahasimet si në raportet tjera periodike, kështu që është vështirë me u kuptuar në këtë formë raporti financiar.

z. Bahri Selimi: Sqaroj për mjetet e kredituar dhe të debituar. Çka është kreditim, nuk është shpenzim, veç bëhet debiti.

z. Agim Mani: Të Investimet kapitale, për 3 muaj janë shpenzuar mjete, aq sa janë shpenzuar për 9 muaj. Për 9 muaj shpenzuara 1,400,000€, që do të thotë diku 50% e mjeteve, aq sa janë shpenzuar mjete në këtë program buxhetor në 3 muajt e fundit. Besoj se kjo nuk është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky raport është i fryballanc, ku ZKF ua dërgon njësive me i njoftuar me gjendjen se ku jemi me gjendjen e mjeteve, sa janë të alokuara, sa mjete janë të shpenzuara. Ky raport është dërguar të ne, në këtë formë sikurse iu dërgohet njësive të brendshme. Për KK drejtori e bënë një raport me përmbledhës. Tremujori i fundit është i pagesave, se ka projekt që është realizuar me herët, ndërkaq pagesa i bëhet me vonë, se paraprakisht nuk bëhet pagesa. Është e kuptueshme që 50% e mjeteve paguhen në TM4, se punët realizohen atëherë.

z. Agim Mani: Nëse i shikojmë TM1, thuhet pagesat duhet të bëhen në fazën e I. Plani dinamik është 30 ditë. Nëse tenderi ka qenë në mars, realizohet deri në qershor, janë fazat e projekteve.

Kryesuesi i Kuvendit: Projektet e mëdha janë me shumë se 30 ditë pune plani dinamik. Ka pasur pagesa edhe në TM2 dhe TM3, por shumica janë në TM4 dhe është e arsyeshme, se punët realizohen atëherë, ka projekte që ekzekutivi e sheh që mbesin mjete nga projekte tjera dhe i realizojnë mjetet në projekte tjera. Realizimi i shpenzimeve çdo herë ka qenë me i madh në tremujorin e fundit sesa në tremujorët tjerë. A po pajtoheni që drejtori me përgatit Raportin për KK me sqarimin lidhur me kërkesat e OJQ, se TM4 asnjëherë nuk na ka ardhur në KK, se kjo pjesë vjen me raportin vjetor financiar. Njëzëri u pajtuan të gjithë që Raporti i përmbledhur me ardhur në KK. **Në saje të kësaj del konstatimi së KPF shqyrtoj Raportin TM4 dhe i njëjti në formë të përmbledhur do të adresohet KK për shqyrtim.**

4. Plani Vjetor i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: KKSBB është këshill i formuar në KK i cili harton planin dhe raportin dhe ia adreson KK për miratim. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Kontributin për këtë pikë do të japim në KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Realisht këto duhet me ardhur vetëm në KK. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky plan pune t'i shkoj KK. Njëzëri ishin të pajtimit të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se, **KPF diskutoj Planin Vjetor të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Janar-Dhjetor 2024. Ky raport i procedohet KK për shqyrtim dhe aprovim.**

5. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Ka hapësirë për kritika, nuk po besoj se është vendi me i diskutuar këtu.

z. Agim Mani: Ku mundën me u gjetur Procesverbalet e KKSBB të publikuara? E di se publikohen, por kësaj herë nuk kam mundur me i gjetur. KKSBB e ka linkun në veti, por nuk i kam pa se janë publikuar. Në procese KKSBB mundesh ne marrë informata me të gjëra. E tha edhe Ardita se ka vend për vërejtje, por duhet me diskutuar në KK, se rekomandimet e KKSBB në zbatim janë gati se zero. Ku është procesverbali që ka raportuar kryetari. Kamerat në qytet janë apo nuk janë funksionale, se nuk ka raport. Në vitin e kaluar është raportuar, ndërkaq sivët jo.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Procesverbalet e KKSBB janë të publikuara, përpos procesverbalit të mbledhjes së fundit. Nganjëherë kanë problem faqet e komunave të Kosovës.

Nënkryetari i Komunës: Fatmir Çaka mban procesverbal në KKSBB, bile edhe i incizon mbledhjet. Ka rekomandime që janë zbatuar, se ka që janë zbatuar, se janë ndalë do biznese që janë hapur afër shkollave që merren me dukuri negative etj.

Procesverbalet e mbledhjeve të KKSBB u vërtetuan nga Zyra e Kryetarit, Mavije Murseli, se janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Me kamerat menaxhon policia, nuk raporton se janë do çështje, në vitin e kaluar, por MPB i ka kaluar në kompetencë të stacionit policor dhe nuk i raportojnë KKSBB

Nënkryetari i Komunës: Në KKSBB është dhënë sqarim për çështjen e kamerave në qytet. Prej ministrisë është kërkuar mos me pasur qasje, ata kërkojnë që ne me ua ndreqë kamerat. Për

derisa nuk kemi qasje, nuk kemi investim, nuk kemi çka me i rregulluar. Tani ministria e ka hartuar me shkresë që ne nuk kemi të drejtë, i ka dorëzuar të policia, dhe për derisa nuk kemi investuar në to, se nuk janë asete tona, nuk kemi çka me i rregulluar. Për derisa na janë ndaluar qasja, ne nuk mundemi me ditur a janë funksionale apo jo kamerat e sigurisë.

z. Agim Mani: Neve si qytetarë na intereson, a janë funksionale kamerat, rekomandimi ka qenë që kamerat me u bërë funksionale.

znj. Dardana Tafili-Dauti; Nuk kemi mundësi me ditur se a janë funksionale, apo jo.

znj. Ardita Rrahmani: Bashkëpunimi duhet me ekzistuar, duhet me biseduar me ata të ministrisë për çështjen e kamerave, sepse është në pyetje çështja e sigurisë. Me ndodhë një rast, kamerat janë, por dalim para aktit të kryer, sepse nuk janë në funksion. Ku është qëllimi i këtij këshilli, sepse nëse nuk ka bashkëpunim me kryetarin, drejtorin, atëherë për çka është ky këshill? Kryetari është kryesues i KKSBB dhe duhet me raportuar për këto çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Qysh mundet me ditur kryetari i komunës a është funksionale apo jo një kamerë, kur nuk ka mbikëqyrje. Kamerat ekzistojnë, unë po pajtohem që ne duhet me u kujdesur për kamerat, por pastaj ata nuk raportojnë se çka po ndodhë me ato kamera. Stacionet policore, policia veprojnë në pavarësi nga komunat, ndërkaq niveli i përgjegjësisë po bien. Rasti ishte në Podujevë, policia. Institucioni i sigurisë menaxhon me kamerat, edhe me ato private. Mirë është që iu kanë hequr edhe komunës. Pyetjen mundeni me bërë edhe në mbledhje të KK, me u përcjellë pyetja të stacioni i policisë për përgjigje. Ne si institucion komunal e kemi për obligim me investuar për siguri të qytetarëve. Besoj se duhet të ekzistoj një akt në ministri që e rregullon këtë çështje, ku duhet me i vendosur, kështu duhet të jetë dikush me funksional, se mundemi me cenuar privatësinë e dikujt.

znj. Ardita Rrahmani: Thellimi i bashkëpunimit duhet me ekzistuar, ndërkaq kjo nuk është arsye për mos me iu besuar institucioneve shtetërore.

z. Agim Mani: Kamerat nuk janë funksionale që 3 vjet, për atë e ngrita pyetjen. Nëse i shikojmë raportet e KKSBB, rekomandime ka pasur për çështjen e kamerave, që 3 vjet nuk janë në funksion.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kur janë vendosur kamerat e sigurisë, a ka pasur ndonjë rregullore për vendosjen e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di, të ne nuk ka ndodhur, por diku tjetër po, p.sh. në Ferizaj po. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë i adresohet KK për shqyrtim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së **KPF shqyrtoj Raportin e punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2023, e procedojmë për KK për shqyrtim.**

6. Informatë për aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Informatën e ka hartuar në vija të trasha Zyra e KK, ka mundësi që është shtuar apo hequr diçka, e diskutojmë. E hapi diskutimin për këtë pikë: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni të pajtimit që kjo pikë t'i kalohet KK në procedurë njoftimi? Të gjithë u pajtuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se, **KPF u Njoftua me Informatën për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës në vitin 2023. Kjo Informatë i procedohet KK për njoftim.**

7. Propozim Vendimi për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut;

Meqë është themeluar Muzeu i qyteti, duhet sipas akteve në fuqi të formohet këshilli për funksionalizimin e tij. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Me vjen mirë që janë vënë në lëvizje funksionalizimi i Muzeut të Qytetit, edhe pse ka kaluar një kohë nga miratimi. Me intereson të di, në bazë të cila kritereve janë përcaktuar anëtarët e këtij këshilli?

znj. Hafize Sallahi: E kam sqaruar atëherë për vonesën e Muzeut të Qytetit nga miratimi, se objekti nuk ka qenë gati, për me realizuar objekti, ka pasur procedura të tenderimit, tani i plotëson të gjitha kushtet. Emrat kanë dalë nga kërkesat e iniciativës qytetarë dhe të OJQ të dala nga lufta që kanë adresuar kërkesë për themelimin e muzeut. Këta emra i ka dërguar këshilli iniciues i themelimit dhe OJQ e dala nga lufta dhe ne i kemi paraqitur të ju, varësisht prej bisedimeve dhe takimeve që kemi pasur me ta dhe besoj që nuk është kush kundër, se ata janë profesionist të kësaj lëmi. Nëse miratohet në KK, ky këshill do të ketë detyrë me hartuar statutin e Muzeut të qytetit. Në vazhdim i znj. Sallahu i përmendi emrat e propozuar. Hajredin Ramajli - jurist dhe arkeolog, Sevdije Shehu - historiane, Ermira Krasniqi - arkeologe, Xhabir Zharku - kryetar i OVL-së në Kaçanik, Ilaz Krasniqi - profesor i historisë, Shefket Palloshi - kameraman, Fatmir Qaka – zyrtar pran DKRS.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është këshill punues, i cili ka me punuar deri me zgjedhjen e organeve drejtuese të Muzeut të Qytetit. Organet e muzeut zgjedhën me konkurs, njerëz të profesionit, ndërkaq këshilli punues me tepër është vullnetar sesa që paguhen shumë për punën që e kryejnë. Emrat janë që mund të japin kontribut në këtë drejtim qoftë nga këshilli iniciues i qytetit apo ata nga Organizata e veteranëve, sepse jam anëtar i organizatës së veteranëve, anëtar i kryesisë dhe e di se është vendosur për emrat nga kjo organizatë, Xhabiri ka qenë komandant i brigadës dhe kryetar i organizatës së veteranëve, me qenë pjesë e kësaj, Ilazi është veteran, por edhe historian, Shefketi e ka një kartotekë bukur të madhe me xhirime nga lufta dhe dokumente të luftës, kështu që nga organizata e veteranëve nuk kemi pasur njerëz me kompetent që japin kontribut në këtë drejtim. Fatmiri është zyrtar i kulturës në kuadër të komunës.

znj. Ardita Rrahmani: Me shumë respekt për secilin individ këtu, historia e Muzeut të qytetit nuk është vetëm nga lufta e UÇK, por këta kanë me trajtuar edhe çka ka ndodhë me herët, besoj se ka edhe vido incizimi edhe të kameramanëve të tjerë në komunë, që mandej munden me i kontribuar kësaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Patjetër, se këta të organizatës janë vetëm 3, ndërkaq 4 anëtarët tjerë janë jashtë organizatës së veteranëve. Nga OVL jemi menduar me i zgjedhur personat të cilët munden me dhënë kontribut me të madh në këtë drejtim. Këshilli nuk është organ drejtues i muzeut, këshilli ka me punuar deri me zgjedhjen e organeve të muzeut.

znj. Hafize Sallahi: Këshilli drejtues ka me pasur mandat 4 vjeçar.

z. Agim Mani: Këshilli punues nuk ka mandat të caktuar. Është dashur me ia caktuar njëfarë dinamike, për me kryer punën sa me shpejt, se ky aktivitet mundet me zgjatur me vite të tëra. Drejtoresha duhet me kërkuar llogari ndaj këtij këshilli punues.

znj. Ardita Rrahmani: Këta nuk munden asgjë me kontribut për shpejtim të procedurës, përderisa nuk pjekën kushtet ligjore dhe administrative, ndërkaq është DKRS ajo që mundet me bërë presion.

Kryesuesi i Kuvendit: Llogari ky komision i jep KK se KK e formon dhe pasi të kryen punën e vet ky këshill, e harton një raport për KK. Secili komitet, komision, këshill që formohet nga

KK, i raporton KK. Në këtë rast ne në fund të vitit kemi me kërkuar një raport të këtij këshilli punues. Nëse komisioni nuk është aktiv, atëherë KK e shkarkon dhe formon këshillin tjetër, se nuk mundem me mbetur ne vetëm në suaza të këshillit punues. Ne duhet me i lëvizur çështjet përpara me ardhur deri të formimi i organeve punuese. Meqë është këshill punues, është çështje e re, ne duhet t'i japim mbështetje që të ecim përpara në këtë drejtim, e jo të lëmë vetëm si akt të themelimit dhe të ngelin çështjet aty. Hapi i dytë është ky, nëse nuk funksionon, atëherë vazhdohet me hapin tjetër.

znj. Hafize Sallahi: Nuk ka qenë e lehtë kjo rrugë me ardhur deri këtu, se është diçka e re. Propozimi për KK për themelim të muzeut, ka ardhur pikërisht nga iniciativa qytetarë dhe nga organizatat e dala nga lufta. Ka qenë edhe premtim i kryetarit dhe ne kemi marrë hapat, jemi konsultuar edhe me Muzeun Kombëtar të Kosovës dhe kjo është procedura që vazhdon. Ky këshill punues që ka me bërë formalizmin e muzeut, nuk ka ardhur me herët në KK se objekti nuk i ka plotësuar kushtet. Tani ky këshill punues është duke pritur sa me shpejt me punuar se ka nevojë edhe për ekspertë nga jashtë, ndërkaq nuk mendoj se do zgjatë shumë puna e komisionit.

znj. Ardita Rrahmani: Unë thashë se nuk janë ky këshill punues, përgjegjës për funksionalizimin e muzeut.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundemi ne me paragjykuar për një këshill sesa ka me punuar ende pa u formua. Ne e shohim me kohë punën e tyre. Nëse nuk angazhohen, ndërrohen, ky këshill i raporton KK, kjo me tepër është punë vullnetare, se sa marrin mëditje nuk ia vlen me punuar, por kjo me tepër është prej vullnetit të tyre për me pasur qyteti një muze. Përgjegjësi këshilli ka, sepse kanë me i lëvizur çështjet, kanë me raportuar në KK, në fund të vitit apo çdo herë kur kërkohet. Diskutime të tjera nuk ka, kjo pikë u shtrua në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimi për emërimin e Këshillit punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut. Propozim Vendimi i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë 3 propozim vendime që me herët na janë kthyer nga MAPL për shkak se të njëjtat njëherë duhet me u shpall interes publik, pastaj me u bërë kërkesa për këmbimin e pronës. Ne në një mbledhje paraprake morëm vendim me i shpallë me interes publik ato prona, tani, tani janë propozimet për këmbimin e pronave. Me herët i kemi kryer me dy procedura, tani po kërkojnë me i nda. Në rasti e parë e kemi:

8. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

Nënkryetari i Komunës: Është ndryshuar tani, me herët janë vendosur me 2 procedura, tani po kërkojnë me i nda.

z. Agim Mani: Është hera e tretë që merremi me këto çështje, se punët nuk kryhen si duhet dhe na ndodhë përsëritja, kjo të merr edhe kohë. Po të ishte mundësia në fillim në bazë të ligjit me u pas kryer, nuk ishim marrë më me to. Janë shpallë pronat me interes publik, **pronat që janë këmbyer, pronat private dhe pronat komunale.** Nuk po e kuptoj përse prona komunale me u shpallë me interes publik? **Pronat që konsiderohen që janë private janë me fleët poseduese shoqërore.** Unë nuk pajtohem që këmbimi me u bërë 27m me 42m, si është caktuar raporti të një pronë, por këmbimi të jetë në raport 1 me 1.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë shpallë me interes publik, prona e Ramiz Shaqiri, Adnan Vishi dhe Mejdi Xhokli. Prona e shtetit nuk shpallet me interes publik, pasi u kërkua që fillimisht me u shpall me interes publik pastaj të bëhet kërkesa për këmbimin e pronës. Ne në mbledhje e fundit të KK e bëmë shpalljen me interes publik të këtyre pronave, tani janë propozimet për këmbimin e këtyre pronave, me prona të komunës. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që t'i shkoj KK kjo pikë. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshmet komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Ramiz (Afiz) Shaqiri; Propozim Vendimi i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Megjithëse ajo rrugë ka përfunduar tani, ndërkaq duhet t'i merret aq sa jep. E dërgojmë në KK për diskutim.

z. Visar Mulaku: Të rruga Emsale Frangu, është bërë zgjerimi i rrugës, se ka qenë problematike pjesa ku qarkullojnë nxënësit, se kjo pjesë lidhet me pjesën e rrugës në shkollën në Dushkajë. U bë incizimi i mureve që ekzistojnë dhe kjo ka hasur në mirëkuptim.

znj. Ardita Rrahmani: Kur u diskutuar kjo çështje në seancën e parë, kryetari ka qenë prezentë, pyetja ime ka qenë: Pse këmbimi nuk u bërë në raport 1 me 1. Ka pasur edhe raste të tjera me herët. Arsyetimi i kryetarit ka qenë, mos me ia prishur shtëpinë, se ai e kishte pas një pjesë të shtëpisë në pronë të komunës. Jo vetëm ajo shtëpi, por ka edhe shtëpia tjera aty që janë në pronë të komunës. Për mos me ia prishë shtëpinë këtij personi, u dashtë me u bërë ky këmbim i pronës, kjo nuk është në rregull.

z. Visar Mulaku: Ne gjithkund e kemi shfrytëzuar rrugën në pjesën e tij. Edhe ju me qenë kryetar, njëjtë kishe vepruar, nuk ia kishe prishur shtëpinë.

z. Agim Mani: Rruga është shtruar në pronën e Shaqirit, është bërë zgjerimi i rrugës pa ndonjë vendim.

z. Visar Mulaku: Zgjerimi i rrugës është bërë një marrëveshje.

z. Agim Mani: Nëse ka marrëveshje, çfarë kuptimi ka të votohet në KK, pasi është shtruar rruga? Me vetëdije të plotë e keni shtruar rrugën. Unë jam për me u zhvilluar procedurat si duhet, sepse çka nëse nuk kalon kjo çështje në KK?

z. Visar Mulaku: Nëse nuk kalon në KK, nuk kemi çka me bërë.

Nënkryetari i Komunës: Vendimet janë miratuar me kohë para dy muajve, por janë kthyer. Rruga ka qenë e ngushtë dhe shumë e rrezikshme. Rruga Emsale Frangu, në vitin 2022 e kam shikuar gjendjen. Ankesa e qytetarëve ka qenë se rruga është shumë e ngushtë dhe e rrezikshme për me kaluar nxënësit dhe nuk ka trotuar. Tani kemi marrë iniciativën me shikuar në gjeoportali qysh janë pronat, ne nuk kemi shkuar deri në atë pikë me ia prishur shtëpitë, por çka ka pasur mure dekorativ, dyer, krejt ia kemi prishur. Ne procedurat i kemi ecur me kohë, por çështja ka qenë që njëherë me i shpallë me interes, pastaj procedura e këmbimit. Përndryshe mendoj se

është bërë shumë mirë, është bërë një rrugë diku 5m, është bërë trotuar dhe u eliminuar rreziku i kalimit të nxënësve.

Kryesuesi i Kuvendit; Shpjegime duhet të kërkojmë për secilën procedurë. Është normale me u bërë studimi me herët, pastaj me u kryer puna. Mos të shikojmë që për çdo punë që është bërë mirë, të nxjerrim probleme, pse kjo punë u bë kështu apo ashtu. Ne po e dimë që u bë mirë, ende nuk e kam pa sesi është realizuar projekti në atë pjesë, por përderisa ne japim kritika pse nuk po bëhet një punë, ndërkaq kur realizohet, pse u bë kështu, mendoj se duhet të jemi të arsyeshëm në do çështje. Nëse qëllimi është me u bë mirë për interesin publik, mos të mendojmë se është qëllimi me u bërë mirë për interesin privat. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë çështje dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e

Aprovoj

Propozim Vendimiin për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Adnan (Feriz) Vishi; Propozim Vendimi i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

10. Propozim Vendimi për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për miratim në parim të vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, me pronën e paluajtshme të personit fizik të Mejdi (Shabi) Xhokli. Ky Propozim Vendimi i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

11. Propozim Vendim për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Në secilin mandat të KK ka pasur emërtime të tilla të komisionit E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Po me intereson të di, propozimet a duhet t' i adresohen këtij komisioni?

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesat vijnë nga administratorët, këshillat e fshatrave, ose ankesa të cilat janë me herët. Kërkesat i adresohen këtij komisioni, i cili komision i kompletton brenda një periudhe kohore kërkesat dhe ankesat dhe i shqyrton, e përgatit raportin dhe e sjell në KK për miratim.

z. Agim Mani: A ka kërkesa dhe ankesa të reja për ndryshimin e emërtimeve të rrugëve, se ka pasur ankesa për emërtim të rrugëve para 4-5 viteve dhe nuk janë zgjidhur?

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkesat dhe ankesat vendosë KK a me i aprovuar apo jo. Disa kërkesa dhe ankesa janë zgjidhur me herët, disa ka mundësi të mos jenë zgjidhur. KK e vendosë a me

aprovua apo jo një kërkesë apo ankesë. Diskutime të tjera nuk ka, këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për emërimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërimit, riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e komunës së Kaçanikut. Ky Propozim Vendimi i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

12. Njoftim me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T –DIAP për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo ka ardhur si njoftim, kështu që e kemi sjellë në KPF dhe KK për miratim, ka pasur mundësi mos me ardhur fare. E hapë diskutimin:

z. Agim Mani: Ky rekomandim nuk ka nevojë të miratohet në KK, është vetëm sa për njoftim. Komisioni ia ka adresuar kryetarit njoftimin për refuzim, kryetari e ka aprovuar refuzimin e ofertës dhe të njëjtën ia ka adresuar KK për njoftim.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky rekomandim nuk votohet, është sa për njoftim. Komisioni është mirë që ka gjetur mundësi me njoftuar KK me vendimin e vet. Për derisa na ka ardhur si lëndë, është dashur të evidentojmë në rend pune. Ky rekomandim është sa për njoftim. A jeni që kjo pikë t'i shkoj KK në procedurë njoftimi? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së, **KPF u Njoftua me Rekomandimin e komisionit vlerësues për Refuzimin e Ofertës N.P.T –DIAP për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në PK Nr. P-70917026-0000-2, kullosë e klasës 4 ZK Kaçanik. Ky rekomandim i kalohet KK në procedurë njoftimi.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:20. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 31.01.2014 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli

